



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA", VLORE

VENDIM
Nr. 9 , Dt. 12.06.2008

Per miratim te kerkeses, per Leje, per perdorimin, e nje pjeseze te burimit ujore "lumi Shushice", per nevojat e larjes te inerteve, subjektit "Shehu" sh.p.k. Vlore.

Ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore" te percaktuara ne nenet 8-pika 1, neni 14-pika 1, shkronja Dh, neni 18 dhe 21, vendimi nr.23, dt. 09.01.2008 i K.M-se, si dhe ne Vendimin nr.1 dt.07.06.2007 te K.K.U-se, duke u bazuar edhe ne kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjektit "Shehu" sh.p.k dhe ne relacionin e A.U.B "Vjose",
K.B.U "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te miratoj Lejen per perdorim, te nje pjeseze te burimit ujore "lumi Shushice" per nevojat e larjes te inerteve dhe ruajtjes te mjedisit, ne impjantin e perpunimit te inerteve, subjektit "Shehu" sh.p.k, fshati Sherisht, Komuna Qender, Qarku Vlore.
- 2- Sasia e ujit qe jepet ne perdorim do te jete 5 l/sek.
- 3- Leja ka afat 5 vjecar, deri ne dt. 12.06.2013
- 4- Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore per zbatimin e ketij vendimi.
- 5- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESIA A.U.B "VJOSE"

Vezir METAJ



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"
Xhevair REXHEPI

